

PARAQITJA DHE SHQYRTIMI I ANKESAVE, VËREJTJEVE, KËRKESAVE, PETICIONEVE DHE INICIATIVAVE QYTETARE

Neni 15

Prezumimi për llogaritjen e afatit të dorëzimit të ankesës

1. Data e paraqitjes së ankesës, për efekt të llogaritjes së afateve procedurale të kësaj rregullore, konsiderohet ajo e:
 - a. depozitimit të ankesës në postë, kur kërkesa dërgohet me postë të porositur;
 - b. depozitimi i ankesës pranë ZIN qëndor apo në NjA;
 - c. regjistrimit nga pajisja përkatëse për marrjen e mesazheve elektronike, nëse ankesa dërgohet me postë elektronike, me telefon apo nëpërmjet aplikacionit në faqen e internetit të bashkisë.
2. Nëse ankesa e dërguar nuk është një dokumenti i lexueshëm, Këshilli njofton pa vonesë dërguesin duke i kërkuar ta ridërgojë ankesën, dhe data e marrjes përfundimtare të ankesës, sipas pikës 1 më sipër, është data e re e marrjes së ankesës.
3. Data e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, konsiderohet edhe si data kur ka ndodhur ngjarja, e cila përjashtohet si datë për efekt të llogaritjes së afateve që ecin kundër Këshillit Bashkiak. Kur data e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

Neni 16

Kontaktet për dërgimin e ankesës

Kontakte për dërgimin e ankesës për shqyrtim tek Këshilli Bashkiak, janë:

1. Email: ankesat@keshilibashkiakvaudejes.gov.al
2. Faqja e internetit e Bashkisë (aplikacioni tek ndërfaqja e Këshillit): www.bashkiavaudejes.gov.al/
3. Zyra me Një Ndalesë e Bashkisë, adresa postare: Rruga, Qafa e Gurit, Bashkia Vau Dejës
4. Tel: 0035526120006

Neni 17

Pranimi dhe regjistrimi i ankesës

1. Ankesa me shkresë drejtuar Këshillit regjistrohet pranë zyrës së protokollit të Bashkisë dhe i dërgohen Sekretarit të Këshillit.
2. Për secilën ankesë caktohet një numër rendor dhe kod.
3. Në raste e dërgimit të ankesës nëpërmjet kanaleve elektronike, ankuesit i dërgohet një njoftim automatik elektronik për marrjen e ankesës nga Këshilli, si dhe kodi i ankesës.

(Burimi: Vkb Vau Dejës Nr.42 Datë 27.07.2020)